



P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) - Rahovec, e mbajtur më **10.06.2026**, me fillim në orën **15:00**, në sallën kuvendit komunal - Rahovec. Mbledhjen e kryesoi si zakonisht kryetari i komunës **z. Smajl Latifi**. Për mbajtjen e mbledhjes kuorumi ekziston. Në fillim të mbledhjes, të pranishëm ishin 19 anëtarë.

Kryetari: Përshëndetje për anëtarët e KKSBB-së, drejtorët e drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec, kapitenin Fazli Morina, përfaqësuesit e bizneseve, përfaqësuesit e klerit fetar, të shoqërisë civile, të komuniteteve pakicë, përfaqësuesit e FSK-së, përfaqësuesit e OSBE-së, LMT-s dhe zyrtarët komunalë. Është takimi **i dytë** i rregullt i kësaj përbërje të re. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,
 - Siguria në trafik;
 - Identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike,
 - Prishja e rendit dhe e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm.
 - Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe të dasmave.
 - Vendosja dhe funksionalizimi i kamerave shtesë të sigurisë në hapësirat publike në rrugët kryesore;
3. Diskutim për aktivitetet e organizuara nga Drejtoria për Arsim për maturantët;
4. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror;
5. Trajtimi i objekteve të braktitura dhe objekteve të vjetra, jo të sigurta;
6. Mbrojtja e ambientit në komunën e Rahovecit;
7. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;
8. Të ndryshme.

Kryetari: Besoj që materialin e keni pranuar me kohë. A ka dikush ndonjë koment për këtë rend dite? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... A ka votë kundër?... Konstatoj që mund të vazhdojmë me këtë rend dite.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryetari: A ka dikush diçka rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, po e vendosi në votim. Kush është “për”?... A ka votë kundër?... Unanimisht aprovohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit, - Siguria në trafik:

Kryetari: Te kjo pikë i kemi edhe nënpikat: Identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike, prishja e rendit dhe e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm, plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe të dasmave dhe vendosja dhe funksionalizimi i kamerave shtesë të sigurisë në hapësirat publike në rrugët kryesore. Angazhimi ynë dhe i policisë duhet të përqendrohet në atë që trotuarin ta kemi vetëm për këmbësor dhe jo për automjete, sepse vazhdimisht ballafaqohemi me nevoja dhe kërkesa që t'i sigurojmë trotuaret. Shohim veprime të herëpashershme, por jo të qëndrueshme sa i përket kësaj çështjeje. Gjendja e sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit është e qetë dhe stabile. Për çështje të tjera e ftoj komandantin e policisë, kapitenin Fazli Morina.

Fazli Morina: I nderuar kryetar, drejtorë, pjesëtarë të FSK-së, të LMT-së, anëtarë të KKS-së. Sa i përket situatës së sigurisë në zonën tonë të përgjegjësisë, ashtu siç e përmendi kryetari, pra, konsiderohet një situatë e qetë dhe stabile. Gjatë këtij afati kohor nga takimi i fundit i KKS-së, janë implementuar dhe vazhdojnë të implementohen 22 plane operative dhe 31 plane të veprimit. Gjatë kësaj kohe janë iniciuar 186 raste, prej tyre 177 vepra penale dhe 9 të tjera incidente jopenale. Nga këto raste: 1 rast grabitje, 9 raste falsifikim i parasë (kryesisht me 1€ dhe 2€), 12 raste vjedhje, 19 raste vjedhje e rëndë, 10 raste asgjësim i pasurisë, 2 raste zjarrvënie, 5 raste armëmbajtje pa leje, 3 raste janë gjetje e mjetit të pashpërthyer, 21 raste dhunë në familje, 14 raste kanosje dhe 1 rast sulm ndaj personit zyrtar. Sa i përket sigurisë në komunikacionin rrugor është duke u impementuar plani i sezonit veror dhe plani i operativ i zgjedhjeve të parakohshme, të cilat përfunduar dhe kaluar shumë mirë dhe pa asnjë telashe. Kemi implementuar gjithashtu planin operativ rreth sigurisë të trafikut rrugor, planin operativ kulti, planin e lirimit të hapësirave të trotuareve. Bazuar në këto plane dhe jo vetëm, janë këto statistika: Janë shënuar 2533 gjoba për kundërvajtje në komunikacion, 86 janë për drejtim të automjetit pa patent shofer, 364 për parking ilegal, 42 për përdorim të telefonit gjatë vozitjes, 5 gjoba për vazhdim të masës së sigurisë, 9 gjoba për prishje të qetësisë publike etj... Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar 23 aksidente me dëme materiale, 3 aksidente me lëndime të trajtuara nga stacioni policor në Rahovec, 8 aksidente me dëme materiale të trajtuara nga stacioni në Gjakovë dhe 2 aksidente me fatalitet, si dhe 35 aksidente të trafikut kanë qenë me lëndime, ku 69 persona janë lënduar. Ka pasur vizita (29 vizita) të pelegrinëve fetarë (830 vizitorë) në manastir në Zogisht dhe në kishat e Lagjes së Epërme dhe në Hoçë të Madhe. Siguria në shkollë: gjatë kësaj periudhe janë iniciuar 6 raste. Një rast armëmbajtje pa leje në shkollën fillore "Hamëz Thaqi" Xërxë, një rast tjetër njëjtë në shkollën e mesme "Ukshin Hoti" Krushë të Madhe, thikë, i dyshuari mësimdhënës. Një rast tjetër: disa nxënës të shkollës "Sadedin Hajda" janë përleshur në oborr të shkollës. Një rast është vjedhje në "Gëzim Hamza" Rahovec dhe një rast sulm në "Isa Boletini", nxënësi sulmon punonjësin teknik. Për rastet e sipërme janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë mbajtur 6 ligjërata në 6 shkollë fillore. Ligjëratat kanë qenë me temën "Bullizmi dhe masat parandaluese". Në 5 shkollë fillore janë mbajtur 5 ligjërata me temën "Ruajtja e ambientit dhe trashëgimisë kulturore" dhe 3 ligjërata në 3 shkollë fillore me temën "Siguria e qarkullimit të këmbësorëve në trafik". Gjithashtu, janë zhvilluar 43 pika të kontrollit afër shkollave, si dhe organizimet e maurantëve kanë kaluar pa asnjë problem. Mos të harroj ta përmendi edhe shkuarjen dhe kthimin nga Haxhi.

Adelina Vuqiterna: Faleminderit për mundësinë që të jem pjesë e këtij këshillit. Dua të lidhem me sigurinë në trafik: a nevojiten më shumë shenja rrugore pranë shkollës, sepse është zonë që ka shumë lëvizje të fëmijëve dhe të rinjve?

Fidan Shala: Te shkollë te semaforët është i nevojshëm një mbikalim, sepse ka shumë qarkullim të nxënësve.

Shani Sylka: Faleminderit, kryetar! Komandant, të falënderoj për këto informata. Me aq sa e kuptova, janë informata rreth asaj që ka ndodhur në 2 muajt e fundit. Ju falënderoj për kujdesin rreth organizimit të shkuarjes

së haxhilerëve. Një pyetje: Patrullimet rreth kulteve fetare. Ruajtja apo patrullimi i tyre, a është kompetencë komunale, apo kërkesë e banorëve? Meqë nuk kemi probleme, ndoshta nuk ka nevojë të bëhet patrullimi fare.

Fazli Morina: Ju falënderoj për pyetjet! Është e vërtetë që ka mungesë të shenjave të trafikut aty te shkolla. Mesiguri mbliidhen kërkesat në komunë dhe tutje veprohet aty në bazë të tenderit, apo nuk e di se si shkon ajo punë, por sa herë kërkohet një shenjë trafiku nuk besoj që intervenohet aty. Te "Isa Boletini" mund të them që është mosangazhim i vetë stafit të shkollës. Unë shpesh kaloj aty dhe befasohe mi se si nxënësit dalin prej asaj shkolle në mënyrë aq të pakontrolluar, thuj se fare kush nuk merret me ta, as mësimdhënësit dhe as policia me ligjërata. Për çështje të sigurisë nënkalmi apo mbikalimi është i mirëseardhur. Hoxhë, faleminderit për komplimentet, e kemi obligim. Sa i përket patrullimit të kulteve fetare, është plan operativ i veçantë (kompetencë kushtetuese), që aplikohet në mbarë territorin e Kosovës.

Kryetari: Faleminderit, komandant! Meqenëse jemi në këtë pikë, insistoj që të vazhdohet me plan operativ që të lirohen trotuaret. Nëse automjetet parkohen në vende joadekuatë, kjo paraqet potencial për dëm të pronës dhe aq më keq edhe në njerëz. Jemi e vetmja komunë që kemi parkingje falas. Lokalet e natës kanë të drejtë të operojnë deri në orën 23:00, por gjatë sezonës së verës edhe për një orë shtesë mund të bëjmë zgjidhje. Parkimi i automjeteve në shesh, aty ku janë të vendosura pllakat: ju lutem që të veprojë inspektorati dhe policia, sepse nuk bën të lejohet që aty të parkohen veturat. E ftoj policinë dhe inspektoratin për bashkëpunim. Sa i përket ndërtimit të mbikalimit që e tha Fidani. Ekziston rreziku që ta ndërtojmë mbikalimin dhe i njëjti të përdoret 2-3 herë në javë. Paraprakisht duhet të bëhet kalkulim se a është kjo alternativë serioze dhe e vetme. Nëse po, atëherë do ta planifikoj për vitin e ardhshëm.

3. Diskutim për aktivitetet e organizuara nga Drejtoria për Arsim për maturantët:

Muhamet Morina: I nderuar kryetar, z. Smajl Latifi! I nderuar komandant, z. Fazli Morina! Të nderuar kolegë drejtorë dhe ju anëtarë të KKSb-së. DKA-ja zhvillon aktivitete të vazhdueshme në të gjitha shkollat edukativo-arsimore dhe në kuadër të këtij bashkëpunimi, kohëve të fundit për maturantët i kemi zhvilluar informatat në lidhje me testin e maturës. Në bashkëpunim me mësimdhënësit, nxënësit kanë ushtruar edhe teste provuese, që i ngjajnë testit të maturës. Gjithashtu, u kemi dhënë informacione se si ata të aplikojnë në konkursin për bursa, të shpallur nga Drejtoria Komunale e Arsimit. Në përgjithësi, këto kanë qenë disa nga aktivitetet e zhvilluara.

4. Parapërgatitja dhe vetëdijësimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror:

Irfan Berisha: I nderuar kryetar, nënkryetar, komandant i stacionit policor, epror i ushtrisë së Kosovës, kolegë drejtorë dhe ju anëtarë të KKSb-së. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, gjatë muajit maj dhe qershor ka zhvilluar aktivitete të ndryshme për vetëdijësimin e qytetarëve për parandalimin dhe raportimin e hershëm të zjarreve. Gjatë kësaj periudhe, me këtë temë janë mbajtur ligjërata nëpër shkolla, me qëllim të vetëdijësimit të nxënësve mbi pasojat e zjarreve. Janë shpërndarë edhe apele në shkolla, sheshe dhe në objekte të ndryshme me frekuentim të lartë të qytetarëve. Duke pasur parasysh ndikimin e madh të rrjeteve sociale, ka filluar vetëdijësimi në rrjete sociale dhe do të vazhdojë në korrik dhe gusht. Gjithashtu, janë ndërmarrë masat për rritjen e gatishmërisë së njësive të zjarrfikësve për sezonin veror. Njësia e zjarrfikësve aktualisht operon me 17 zjarrfikës dhe duke pasur parasysh numrin e banorëve në komunën e Rahovecit, ky numër i zjarrfikësve është i vogël. Në fund, ju bëj thirrje të gjithë anëtarëve të KKSb-së që të na mbështetnin në rritjen e vetëdijësimin e komunitetit lidhur me rrezikun nga zjarret dhe parandalimin e hershëm të tyre.

Kryetari: Faleminderit, drejtor! Fatkeqësisht, zjarrfikësit nuk i rekrutojmë ne, por AME-ja. E dimë që numri është i vogël, por nuk kemi të drejtë të bëjmë asgjë. Shpresoj që të mos kemi nevojë për intervenim.

5. Trajtimi i objekteve të braktisura dhe objekteve të vjetra, jo të sigurta:

Kryetari: Kjo pikë është mjaft e rëndësishme dhe besoj që për mbledhjen e ardhshme do ta kemi një informatë më të detajuar rreth gjendjes së këtyre objekteve dhe veprimet që i kemi ndërmarrë ne si autoritete. Pra, në

mbledhjen ardhshme të KKS-së si pikë e veçantë do të jetë edhe pika ku precizohen këto lloj objektesh me hartë dhe fotografi, si dhe çka kemi bërë ne si komunë rreth tyre. Nëse dikush nuk ka diçka për të thënë, vazhdojmë me pikën e gjashtë.

6. Mbrojtja e ambientit në komunën e Rahovecit:

Kryetari: Ne i kemi dy kompani që mbledhin mbeturina të amvisërisë: Ekoregjionin dhe Ekodrininë. Gjithashtu, rrugës për Drenoc në krahun e majtë është deponia inerte legale. Ndërkaq, shohim mbeturina të amvisërisë në lumin “Duhlllo”, në “Rimnik”, në brigjet e “Drinit të Bardhë” madje edhe mbetje shtazore. I kërkoj inspektoriatit dhe anëtarëve të KKS-së që duhet të gjejnë modele për denoncimin e atyre që hedhin mbeturina aty ku nuk e kanë vendin. Unë e di që edhe policia ka të drejtë të shqiptojë gjoba mandatore për mjedis, por nuk e di nëse e kanë aplikuar ndonjëherë. Jemi duke bërë mjaft ndotje dhe jemi të pakujdesshëm në këtë çështje. Mendoj që gjobat mandatore nuk janë të mjaftueshëm. Personalisht, si kryetar komune, ju e dini që e kam bërë një fond për secilin që denoncon raste shpërblehet me 50€ dhe emri i tij mbetet konfidencial. Nëse raportimi është me masa të dëmit më të mëdha, atëherë shpërblimi rritet. Mbledhja e mbeturinave natyrisht që është kosto e madhe për komunën, sepse skajet e rrugëve çdo ditë ndoten nga njerëzit e pandërgjegjshëm dhe kjo është e tmerrshme. Kjo është arsyeja që denoncimi i rastit nga njerëzit e ndërgjegjshëm është shumë i rëndësishëm dhe jam i pakënaqur në raport me atë që shohim, në raport me mjedisin ku jetojmë. Kemi gjoba mandatore, por nuk janë të mjaftueshme dhe nuk e kanë rezultatin e nevojshëm që duhet ta presim ne.

6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore:

Nora Boshnjaku: I nderuar kryetar, nënkryetar, komandant, anëtarë të KKS-së, kolegë. Në emër të drejtorisë për Punë Inspektuese, më lejoni t’ju paraqes një pasqyrë të angazhimeve dhe rezultateve konkrete. Sa i përket pikës rreth objekteve të vjetra dhe të braktitura: si drejtori e kemi vlerësuar se kjo është një çështje për trajtim urgjent institucional, prandaj ju njoftoj që kemi filluar me identifikimin e objekteve të vjetruara dhe njëkohësisht të rrezikshme në të gjithë territorin e komunës. Ky proces do të jetë i strukturuar dhe në bashkëpunim me institucionet relevante. Nga inspektorët e tregut, gjatë periudhës raportuese janë ndërmarrë veprime konkrete, ku si rezultat 38 biznese janë formalizuar dhe regjistruar. Kemi lëshuar mbi 20 pëlqime pune për subjektet që i kanë plotësuar kushtet ligjore, po ashtu janë kontrolluar rreth 50 biznese për inspektim të çmimeve dhe deklarimin e produkteve. Gjithashtu, kemi shqiptuar edhe 11 gjoba mandatorë për mosrespektim të orarit të punës nga subjekte të ndryshme. Sa i përket sigurisë së produkteve ushqimore: është shumë e rëndësishme të theksohet se inspektorati sanitar i ka kompetencat kryesore në këtë fushë, ndërsa inspektorët e tregut nga ky muaj kanë kaluar në nivel qendror, respektivisht në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Si drejtori do të vazhdojmë të bashkëpunojmë ngushtë me institucionet përkatëse, për të garantuar mbrojtjen e shëndetit publik dhe respektimin e standardeve në treg. Në aspektin e mbrojtjes së ambientit, rezultatet kanë qenë konkrete, jo edhe aq të kënaqshme. Kemi vazhduar me kontrolle të vazhdueshme me kontrolle të mjedisit, duke i shqiptuar 39 gjoba mandatorë për ndotje të mjedisit. Gjithashtu, i kemi obliguar 26 subjekte që të pajisen me leje mjedisore dhe kemi monitoruar zbatimin e akteve për menaxhimin e mbeturinave dhe automjeteve të vjetruara. Në total për pesë muaj, kemi shqiptuar 96 gjoba mandatore dhe i kemi ekzekutuar 20.350 euro të hyra totale në drejtorinë e Inspektoratit. Nga kjo foltore, ju bëj thirrje që të raportoni në platformën “raporto-shpërblehu”, për të gjitha ndotjet e mjedisit që ju i shihni dhe ju garantoj që informatat do të jenë anonime.

Shaip Shala: Faleminderit, kryetar! Përhëndetje për të gjithë! Nuk jemi parë që nga fillimi i muajit mars. Diskutimi im ka të bëjë me sigurinë dhe kontrollin e produkteve, jo ushqimore, por farmaceutike. Stafi punonjës nëpër barnatoret farmaceutike është i pakualifikuar dhe nuk kanë lidhje me farmaci. Po e tregoj një anekdotë rreth një rasti të barnave të gabuara, që personalisht më ka ndodhur mua. Një ditë para pak dhimbje në muskul dhe fizioterapisti më sugjeroi “dolofix muscular” dhe unë shkova në barnatore, e vendosa në qese kutinë. Erdhi

koha e përdorimit dhe e shikova që punëtori i barnatores më ka dhënë “dolofix menstrual”. Natyrisht, e quditshme kjo dhe shkova e ktheva. Më kërkuan falje, por iu ktheva duke i falënderuar, sepse tanimë e kanë krijuar një anekdotë që do të përmendet brez pas brezi.

Kryetari: Faleminderit, Shqip! E di që nuk e keni lajmëruar këtë rast, sepse tani për herë parë po e përmend këtu. Sidoqoftë, këto raste duhet të raportohen. Ndoshta edhe kjo lidhja jonë brenda komunitetit, shpesh na bënë që mos t’i lajmërojmë rastet në inspektoriat, në polici, në shkollë etj... Natyrisht që kjo nuk është praktikë e mirë dhe kështu nuk ndërtohet shteti. Pikërisht, ne këtu në KKSB duhet ta marrim këtë rol, sepse pa informatë ose fakt nuk mund të dënohet askush. Në rastet e tilla, nëse dikush punon pa licencë, e kuptueshme është që duhet t’i mbyllet veprimtaria, si dhe personi në fjalë rrezikon burgun, sepse të gjitha janë të parapara me ligjet e Republikës së Kosovës. Në anën tjetër, ne nuk po veprojmë me lajmërime, sepse të gjithë po na dalin “të njohur e familjarë”. Ju lus edhe një herë, nuk ka police që mund të bëjnë diçka nëse mungon informata dhe nëse nuk ka bashkëpunim, njëjtë është edhe për inspektorët. Si konkluzion: e lus inspektoratin që nëse sheh barna me afat të skaduar, lagështi dhe nuk sheh standarde, atëherë të veprojë menjëherë.

8. Të ndryshme:

Shani Sylka: Sa i përket ruajtja e mjedisit, mendoj që pika kryesore i takon nivelit qendror dhe kjo pikë është mungesa e inspektorëve. Në të gjitha restorantet gjatë dasmave konsumohet cigarja, ndërsa me ligj është e ndaluar. Të paktën duhet t’i kemi 2-5 inspektorë, që gjatë sezonës t’ju bëjnë vizitë ambienteve të tilla. Me të gjitha këto instrumente shtetërore, procesi i vetëdijesimit të popullit shkon më ngadalë. I shpejtë është procesi i gjobave dhe kontrolleve të ndryshme. Ju bëj apel për shtim të numrit të inspektorëve. E kam pasur një rast me një dasmë, së bashku me ministrin e atëhershëm të Shëndetësisë, dr. Ferid Agani. Në fillim kur ministri e vërejti që pihet cigarja në dasmë, i thash: “ministër, merre fjalën dhe kritikoi”. E mori fjalën, diskutoi, por në fund nuk përmendi asgjë. Më tha që i erdhi keq, për shkak të dasmës. Për këtë arsye, them që vetëdijesimi është i ngadalshëm dhe se rritja e numrit të inspektorëve është i domosdoshëm.

Fidan Shala: Pajtohem plotësisht me atë që e the rreth ambientin, kryetar! Problem është nxjerrja e zhavorrit dhe lëvizja e kamionëve rrugës për Opterushë, Zoqisht dhe Brestoc, pas orës 16:00. Vërehet që asfalti mbushet me dhe, por edhe me zhavorr dhe e kupton që gjatë gjithë natës kanë punuar.

Kryetari: Faleminderit, Fidan! Janë konfiskuar makineri dhe kampionë. Duhet ta dimë që eksploatimi i atij lloji të dheut bëhet me pronarë privatë. P.sh: ju e keni një tokë aty dhe privatisht merremi vesh për bartjen e dheut. Është e vërtetë që duhet të kenë pëlqim mjedisor dhe pëlqim nga komisioni i pavarur për miniera dhe minerale. Ne, si institucion disa herë i kemi dënuar, por komuna nuk i jep ato toka të pasura me atë lloj rëre, por pronari privat, të cilët besoj që ju e dini se kush janë. Jemi në temë dhe shumë të informuar, vetëm duhet t’i lajmëroni inspektorët. Hoxhë, nuk kemi të drejtë të rekrutojmë inspektorë, sepse janë të centralizuar në ministri. Merre me mend, vetëm një inspektor të mjedisit e kemi. Gjithashtu, janë centralizuar edhe inspektorët e tregut, sanitarë dhe veterinarë. Sidoqoftë, ne nuk lodhemi asnjëherë, do t’i ftojme edhe ata nga qendra që ta bëjnë punën e tyre. Ju falënderoj të gjithëve për kontributin.

Procesmbajtësi

Albion Krasniqi

Kryetari i Komunës

Smajl Latifi



